



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

NJOFTIM

“PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NIVEL INSTITUCIONAL NË UE”

Me Vendim të Senatit Akademik të UE-së Nr. 16, datë 22.07.2021 është vendosur shpallja e procesit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional në UE si më poshtë:

1. Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit.
2. Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës.

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione në fushat që lidhen me:

1. garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit;
2. marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.

Neni 24 i Statutit të UE-së, Komisione të përhershme në nivel institucional në UE përcakton:

- a) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
- b) Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët, 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.

Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel institucional në UE vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 22.07.2021 dhe përfundon më datë 23.07.2021.

Kandidatët e interesuar do të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik, dorazi ose në rrugë elektronike në adresën: eglantina.zace@uniel.edu.al, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesa
2. Kopje e dokumentit të identifikimit
3. Kopje të titullit akademik ose gradës shkencore (për kandidatin nga personeli akademik).